



Republika e Kosovës \* Republika Kosova \* Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale  
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale  
Independent Commission for Mines and Minerals



**Dt. 11.09.2014**

### **FTESË PËR PARAQITJE TË OFERTËS**

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, publikon këtë ftesë me anën e të cilës i fton të gjithë personat juridik dhe fizik me qëllim të lidhjes së një kontrate për shfrytëzimin e objektit të ofertuar si në vijim:

**Titulli i aktivitetit:** “Marrje në shfrytëzim të objektit për zyre me qira, me distancë brenda hartës së qytetit e cila do të ju dërgohet të gjithë të interesuarve (Zona 1 dhe 2) .

Nr. i pjesës	Përshkrimi	ÇMIMI NJËSI
1.	Hapësira për zyre (Objekti) me qira prej 1250 m <sup>2</sup> – deri në 1300 m <sup>2</sup>	Çmimi për m <sup>2</sup>

#### **Kushtet që duhet t’i plotësojë ofertuesi:**

1. Oferta duhet të jetë dhënë nga ofertuesi apo personi i autorizuar i tij, i cili ka për qëllim t’i përgjigjet kësaj ftese;
2. Oferta duhet t’i përmbajë elementet thelbësore të paraqitura në kërkesat teknike;
3. Dëshmi nga gjykata kompetente që nuk jeni nen hetime
4. Dëshmi se nuk keni obligime tatimore (për biznese vërtetim nga ATK-ja ndërsa për persona fizik dëshmi mbi pagesën e tatimit në pronë për objektin përkatës)
5. Përshkrimin e objektit;
6. Dokumentacionin grafik – lokacioni; fletën poseduese të objektit dhe truallit në të cilin është ndërtuar objekti.
7. Fotografitë e objektit

**Kushtet e ofertimit:** Të gjithë të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e Specifikacionit Teknik të Obligueshëm, në Zyrën e Administratës së KPMM-se, në adresën: Rr, Armend Daci Nr 1, Prishtinë çdo ditë pune prej orës 08:00-16:00 ose edhe në e-mailin zyrtar: [icmm@kosovo-mining.org](mailto:icmm@kosovo-mining.org)

Ofertat e nënshkruara dhe të mbyllura në zarf do të pranohen nga KPMM-ja deri më datë: **25.09.2014**, koha 14:00, Zyra e Administratës nr 205.